



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AVIACIONIT CIVIL

Nr. 77/2008 Prot

Tirane 13/08/2008

URDHËR

Nr. 77, Date 13/08/08

PËR PËRCAKTIMIN E

AUTORITETIT KOMBËTAR MBIKQYRËS

1. Bazuar ne Ligjin 9658, datë 18.12.2006, "Marrëveshja Shumëpalëshe midis Komunitetit Evropian dhe Shteteve të tij Anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Mbi Krijimin e një Zone të Përbëshkët Evropiane të Aviacionit" si edhe bazuar në VKM Nr.548 datë 29.08.2007, Për disa Shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.96, Datë 21.2.1995 të Këshillit të Ministrave" Për Krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil", të ndryshuar,

URDHEROJ

1. Drejtoria e Trafikut Ajror të kryejë funksionet e Autoritetit Kombetar Mbiqyres (AKM).
2. Objekti i Veprimtarisë së AKM do të jetë mbikqyrja e sigurisë dhe monitorimi e programimi, në nivel kombëtar, i zbatimit të praktikave të Shërbimit të Trafikut Ajror.
3. Ngarkohet AKM:
 - a. Të hartojë rregulloren e punës dhe planifikimin e programit zbatues të kërkesave rregullative për sigurinë në Aviacionin Civil Shqiptar (KRRSE/ESARR).
 - b. Të hartojë manualit të punës së mbikqyrjes kombëtare të praktikave të shërbimit të trafikut ajror.

4. Punonjësit e Drejtorisë së Shërbimit të Trafikut Ajror, të cilët kane kryer kurset SAF-NSA dhe ATM SAF-AUDIT (në institutin IANS Luxemburg), dhe që mbajnë një licencë të vlefshme për auditimin e Ofruesve të Shërbimit të Trafikut Ajror të lëshuar nga EUROCONTROL, të kryejnë funksionet e auditorëve të sigurisë, për auditimin e Ofruesve të Shërbimit të Trafikut Ajror.

5. Drejtoria e Trafikut Ajror do të kryejë funksionet e Autoritetit Kombëtar Mbikqyrës, deri në momentin e krijimit të një departamenti të vecantë për këtë qëllim.

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Ervin MAZNIKU
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

